



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.45/2018
Prishtinë, më 23.10.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari- Lila, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj, Memli Krasniqi, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Glauk Konjufca.

Pjesëmarrës tjerë: Vatra Qehaja dhe Arta Dehari – LVV, Diellza Luzha – KDI, Arlind Gruda dhe Besjana Bajrami – Ekonomia Online, Sanie Jusufi – Koha Ditore, Dorentina Kastrati – BIRN, Albulena Avdiu – Ekonomia Sot dhe Dren Ajeti- Klubi i Prodhuesve.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.10.2018;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë për kandidatet për kryesues të Bordit të ZRRE-së;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit;
5. Te ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.10.2018

Procesverbali i mbledhjes së datës 9.10.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë për kandidatet për kryesues të Bordit të ZRRE-së

Kryetarja i njoftoi anëtarët e komisionit se Qeveria ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin e saj lidhur me numrin e kandidateve për kryesues të Bordit të ZRRE-së, duke sjellë edhe emrat e dy kandidatëve të tjerë, sipas kërkesës së Komisionit. Debati është shterë lidhur më këtë çështje kërkoj që të votohet.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Kuvendi të zgjedhë me votim të fshehtë 1 (një) nga 4 (katër) të propozuarit e Qeverisë, për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si vijon:

- 1.1. Bekim Jakupi;*
- 1.2. Petrit Pepaj;*
- 1.3. Fadil Ismajli;*
- 1.4. Perparim Kabashi.*

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit

Kryetarja theksoi që komisionet e përhershme, të cilat e kanë shqyrtuar këtë raportin me amendamente nuk kanë dhënë vërejtje, andaj, i ftoi që ta procedojnë tutje për lexim të dytë.

Komisioni, me 8 (tetë) vota “për” dhe 1 (një) “kundër”, nxori këtë:

Përfundim

1.Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit.

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

5. Të ndryshme

Muharrem Nitaj kërkoj sqarime lidhur me panelin për vlerësimin e kandidatëve për anëtarë të KOSTT-it, nëse është praktikë në përputhje me ligjin mënyra e zgjedhjes së panelit, ku iu referua një rasti në Komisionin për Bujqësi, ku një kandidat e ka dërguar rastin në gjykatë, pikërisht për shkak të përbërjes së panelit. Kërkoj që nëse mund të korrigjohet votimi i këtij paneli vlerësues dhe pjese e këtij paneli të jenë të gjithë anëtarët e Komisionit dhe jo vetëm 3 (tre) nga ta.

Kryetarja theksoi se votimi i panelit është legjitim, ligji nuk specifikon se sa anëtarë duhet të jenë. Kam propozuar me sugjerim edhe të implementuesit të projektit për mbështetje nga Ambasada Britanike, që në këtë panel vlerësues të jetë hierarkia e komisionit që përfshin pozitën, opozitën dhe minoritetet dhe ju jeni pajtuar për këtë, pastaj nënkryetari i parë i komisionit u tërhoq nga paneli dhe e propozoi deputeten Hykmete Bajrami. Në Ligjin për Energjinë Elektrike, neni 14, paragrafi 6.2. thuhet: *Komisioni Parlamentar përkatës për Energji pas pranimit të dosjes së aplikuesve, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku 2 (dy) kandidatë për një pozitë të lirë.* Në fund vlerësimet e panelit do të vijnë për votim në këtë Komision dhe pastaj të përcjellën për seancë.

Për këtë çështje pro dhe kundër përbërjes së panelit diskutuan deputetet: Liburn Aliu, Memli Krasniqi, Dardan Sejdiu, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila dhe Duda Balje.

Kryetarja konstatoi se në pikën të ndryshme, komisioni nuk mund të merr vendim dhe e shpalli debatin të mbyllur.

Veton Berisha propozoi që në një nga mbledhjet e komisionit të ftohet për raportim Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Rasim Demiri, të njoftojë komisionin lidhur me realizimin e planit të punës së ministrisë dhe me theks të veçantë për subvencionet.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Dardan Sejdiu kërkoj që në përgjithësi të ftohen ministrat e linjës për raportim e me saktësisht kërkoj që në raportim rreth procesit të kontratës për ndërtimin e termocentralit “Kosova së Re” të ftohet Ministri i Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Hykmete Bajrami kërkoj që në raportim të ftohet edhe Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, z. Endrit Shala, në lidhje me shkarkimin e sekretarit nga ish- ministri Hasani, për shkak se siç ka thënë ai për arsye të keqpërdorimeve që ka bërë sekretari në këtë ministri edhe me subvencione, por edhe me punësime.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Kryetarja theksoi se pakoja ligjore që ka të bëjë me reformën e administratës publike, siç keni mund ta vëreni edhe ju, kjo pako prek edhe shumë agjenci që raportojnë në këtë komision,

propozoi që të mbahet një takim me këto agjenci në lidhje me këtë çështje. Në planin e punës së komisionit kemi edhe punë të tjera, përveç shqyrtimit të projektligjeve, pasi që kemi shqyrtuar të gjitha projektligjet që kemi pasur, dhe për këtë falënderoi pozitën dhe opozitën për kontributin e dhënë, dhe pasi nuk kemi projektligje në shqyrtim në këtë kohë, mund shfrytëzojmë që të vizitojmë ndonjë nga agjenci, ministrinë e linjës apo ndonjë biznes.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Staf i mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA